

**RAMI MEMUSHAJ****“PROPOZIME PËR DREJTSHKRIMIN” – PIKËNISJE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTSHKRIMIT TË SHQIPES****Abstrakt**

Norma gjuhësore, si shumatore e ndryshimeve gjuhësore që ndodhin në praktikën ligjërimore të folësve dhe e vëmendjes së planifikuesve gjuhësorë ndaj saj, nënkupton ndërhyrjen për përmirësimin e zgjidhjeve të veçanta të saj që paraqiten të vështira për t'u zbatuar në të shkruar e në të folur. Nga këto norma, drejtshkrimi, që pasqyron arritjet në fushën e fonetikës dhe të gramatikës normative, e bën të nevojshme rivlerësimin e rregullave. Por çështja është se si duhen bërë këto ndryshime: duke ia lënë këtë punë një grupi të ngushtë apo duke tërhequr mendimet e trupës së gjuhëtarëve shqiptarë. Në këtë kumtesë mbrohet pikëpamja që miratimi i ndryshimeve nuk i duhet lënë një grupi të ngushtë dhe që ndryshimet e propozuara duhen bërë jo me votim, po me bashkëpëlqim. Këto propozime të bëra gjatë këtyre 50 vjetëve, që janë përmbledhur në veprën në dy vëllime “Propozime për drejtshkrimin” (2022), duhet t'u paraqiten gjuhëtarëve në formën e një ankete. Përgjigjet e anketimit, pasi të filtrohen nga një komision duke pranuar propozimet për të cilat pajtohen 90-100% e të anketuarve, t'i paraqiten për miratim një konference të gjerë (ose kongresi), me pjesëmarrjen e gjuhëtarëve (doktorë, profesorë të asociuar dhe profesorë), të lëvruesve e të botuesve të të gjitha trevave shqipfolëse.

**Fjalë çelës:** *alternativë, drejtshkrim, këshill, konferencë, normë, parim fonetik, përmirësim, platformë, propozim, rregull, shqipe*

1. “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe” po hyn në të pesëdhjetat. Përvoja gjysmëshekullore tregon se rregullat e tij janë përvetësuar në një shkallë të pëlqyeshme dhe janë zbatuar në ligjërimin e shkruar. Megjithatë, do theksuar se shkalla e zbatimit të tyre ka qenë në përpjesëtim të drejtë me kujdesin e shtetit shqiptar dhe të shoqërisë shqiptare në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni (të Veriut). 20 vjetët e parë, kur kujdesi i shoqërisë shqiptare për gjuhën ishte i lartë, i shprehur në vendime të qeverisë shqiptare për gjuhën dhe në orientimet me frymë kombëtare të Konsultës së Prishtinës për shqiptarët në ish-Jugosllavi, karakterizohen nga zbatimi i normës drejtshkrimore në të gjithë prodhimin letrar (në veprimtarinë shkresore të administratës, në legjislacion, në gazetatat, në

revistat dhe në botimet e të gjitha fushave). Por nuk mund të thuhet e njëjta gjë për këta 30 vjetët e fundit, kur shoqëria shqiptare në tranzicion nuk e ka pasur në vëmendje kujdesin ndaj gjuhës, gjë që ka çuar në shpërfilljen e normave të gjuhës standarde. Në botimet e të gjitha llojeve sot, edhe në ato që i janë nënshtruar korrektimit gjuhësor, nuk është e vështirë të gjejmë gabime të shumta drejtshkrimi, gramatikore e leksiko-semantike.

Kjo shkujdesje në zbatimin e normave të gjuhës, që nisi në vitet '90 të shekullit që shkoi dhe që vijon edhe sot e gjithë ditën, është parë qysh në fillim me shqetësim nga gjuhëtarët në mbarë trojet shqipfolëse. Por rrugët e propozuara për ta kapërcyer këtë gjendje kanë qenë të ndryshme. Ndërsa shumica e gjuhëtarëve kanë qenë për forcimin e kujdesit për zbatimin e normave të gjuhës standarde nga shkolla dhe institucionet shtetërore, duke nënkuptuar me këtë nevojën e ndërhyrjes së shtetit, një palë tjetër ishte e mendimit se gabimet në zbatimin e normave, veçanërisht të normës drejtshkrimore, shpjegoheshin me vështirësinë e përvetësimit të rregullave të drejtshkrimit sidomos nga folësit e gegërishtes. Në të vërtetë, gabimet drejtshkrimore nuk lidhen me natyrën e rregullave të drejtshkrimit, dmth. me shkallën e vështirësisë në përvetësimin e tyre, po me bjerrjen e kulturës gjuhësore të shoqërisë shqiptare, gjë që ka ardhur, së pari, prej heqjes dorë të autoritetit shtetëror nga kujdesi për mbrojtjen gjuhës, por edhe nga puna e dobët e shkollës, si dhe nga shpërfillja e normave të gjuhës standarde prej aktorëve dhe faktorëve të përfshirë në ligjërimin publik.

**2.** Gjithsesi, praktika e gjatë e zbatimit të kodit drejtshkrimor ka nxjerrë në pah edhe një varg problemesh që lidhen me formulimin dhe me strukturën e rregullave, por edhe me zhvillimet në fushën e fonetikës e të gramatikës normative, si dhe me ndryshimin e sistemeve politike në hapësirat shqipfolëse. Këto probleme janë vënë në pah nga gjuhëtarët në shkrime e kumtesa duke filluar që nga viti 1976 e deri më 2014, kur propozimet pothuajse shterin. Zhvillimet në fushën e gramatikës (të pasqyruara në gramatikën akademike të gjuhës standarde), terminologjia e re e përdorur në këto tekste normative, zgjidhjet e reja të disa çështjeve morfologjike, si shumësi i emrit, format foljore etj., e kanë bërë të domosdoshëm zëvendësimin me terma të kohës të disa termave të përdorur në formulimin e rregullave, si dhe ndryshimin e disa zgjidhjeve të çështjeve morfologjike në përputhje me zgjidhjet që u është dhënë në gramatikën akademike. Veç kësaj, disa rregulla paraqiten të vështira për t'u zbatuar, për shkak të natyrës josistemore të tyre, që kanë si pasojë më shumë përjashtime nga ç'duhet. Praktika vuri në spikamë edhe disa zgjidhje që nuk qëndronin dhe që duheshin korrigjuar për t'ua shtuar forcën përgjithësuese rregullave, gjë që do të çonte automatikisht në pakësimin e numrit të përjashtimeve. Më në fund, ndryshimi i sistemit në Shqipërinë politike dhe në trojet shqiptare jashtë kufijve të saj shtetërorë e bëri të domosdoshme braktisjen e disa rregullave e zgjidhjeve drejtshkrimore të bazuara në parimin simbolik, në

të cilat ka ndikime të natyrës ideologjike, si dhe zëvendësimin e ilustrimeve që lidhen me institucionet e sistemit që u përmbys me ilustrime të tjera, që duhet të mbulojnë gjithë hapësirat shqipfolëse.

Të gjithë këta faktorë, brenda- e jashtëgjuhësorë e bënë të domosdoshëm ngritjen e një organizmi që do të kishte për detyrë kujdesin për zbatimin e normave të gjuhës standarde, por edhe punën për risimin e terminologjisë së drejtshkrimit dhe përmirësimin e rregullave. Këto qenë arsytet pse u krijua Këshilli Kombëtar për gjuhën. Ky këshill, që u krijua në vitin 2004, pati një komision për drejtshkrimin me dy grupe (i Tiranës dhe i Prishtinës), detyra e të cilit do të ishte puna për përmirësimin e rregullave. Të dy nënkomisionet e drejtshkrimit funksionuan rreth dy vjet, duke bërë propozime e kundërpropozime. Ato e ndërprejnë punën në vitin 2006 për shkak të reformës së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Pas përfundimit të reformës, Këshilli Kombëtar u riformatua në Këshill Ndërkademi, ndërsa komisioni i drejtshkrimit u shpërbë dhe punën e tij e mori përsipër një nga anëtarët e Këshillit. Për t’u dhënë propozimeve natyrën e një vendimi kolegjal, aty nga fillimi i vitit 2013 u krijua pranë departamentit të gjuhës shqipe të Universitetit të Tiranës një komision, që pati si detyrë të miratonte ndryshimet e propozuara nga anëtari i Këshillit që e kishte marrë përsipër këtë punë<sup>1</sup>.

3. Këshilli Ndërkademi e vijoi punën deri në qershor të vitit 2014, me rikompozime të anëtarësisë dhe me ndryshimin e objektit të punës. Ajo që vlen të thuhet për këtë Këshill është se gjatë periudhës që ekzistoi nuk kreu asnjë veprimtari në mbrojtje të gjuhës dhe nuk prodhoi asnjë dokument për të tërhequr vëmendjen e shtetit dhe të shoqërisë për zbatimin e normave të standardit. Ai u mor vetëm me ndërhyrjen në normat drejtshkrimore, morfologjike e sintaksore. Sa për drejtshkrimin, ai synoi jo përmirësimin e rregullave të drejtshkrimit, po ndryshimin e drejtshkrimit, duke na dhënë si produkt një drejtshkrim të ri të bazuar në parimin fonetik, në kuptimin e ngushtë të fjalës, dmth. në ortoepinë e disa të folmeve veriore e jugore. Ky drejtshkrim i ri, që, sipas përlllogaritjeve tona, do të prekte rreth 12-16% të fjalësit të “Fjalorit të gjuhës shqipe” (2006)<sup>2</sup>, do të ishte më i vështirë për t’u zbatuar, sepse nga rreth 316 rregulla e përjashtime që ka drejtshkrimi ekzistues, drejtshkrimi i ri do të kishte 385 rregulla.<sup>3</sup> Dihet polemika e zhvilluar gjatë kësaj periudhe brenda Këshillit, por edhe në shtyp midis përkrasësve të

---

<sup>1</sup> K. Topalli, “Materiali që do të paraqitet për diskutim në grupin e drejtshkrimit”, në *Propozime për drejtshkrimin*, vëll. I, Shkup, 2022, f. 115-160.

<sup>2</sup> R. Memushaj, “Të mbrosh gjuhën, nuk është e turpshme”, në *Për shqipen standarde III*, Kristalina, Tiranë, 2017, f. 274.

<sup>3</sup> R. Memushaj. “Sa është e mbështetur gjuhësisht reforma ndërkademi e drejtshkrimit?”, në *Për shqipen standarde III*, Kristalina, Tiranë, 2017, f. 66.

ndryshimeve dhe atyre që ishin jo për ndryshime të thella, po për përmirësimin e rregullave.

Falë kundërshtimit të gjuhëtarëve që ishin kundër ndryshimit të drejtshkrimit dhe prekjes së normave morfologjike e sintaksore, projekti ndërakademik dështoi. Siç është vënë tashmë në dukje, shkaku i dështimit të projektit ndërakademik ishte mungesa e një platforme të përbashkët të të dy akademive, që erdhi nga mefshhtësia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe dorëzimi i saj para trysnisë së Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Si rrjedhim, Këshilli u orientua nga platforma e vitit 2006 e ASHAK-ut për “ndryshimet që duhet të pësojë drejtshkrimi me qëllim të thjeshtësimit e të begatimit në drejtim të kahjeve të sotme zhvillimore të shqipes standarde”<sup>4</sup>. Kjo platformë me frymëzime krahinore, që pati edhe mbështetjen politike të Tiranës, u zbatua nga Këshilli Ndërakademik, i cili prodhoi një projekt që nuk sillte përmirësimin e rregullave, sikundër ishte shpresuar të ndodhte nga iniciatorët e krijimit të Këshillit, po përmbysjen e drejtshkrimit dhe, bashkë me të, edhe të bazës së gjuhës standarde.

Por mbi ç’bazë do të bëheshin ndryshimet? Këshilli Ndërakademik nuk voli mendimet e shprehura gjer atëherë në shtypin shkencor nga gjuhëtarët në Kosovë, Shqipëri e Maqedoni për të nxjerrë rastet problematike dhe për të vendosur për zgjidhjen e tyre, po u nis nga dëshirat e disa prej anëtarëve të tij, të cilët nuk e kishin drejtshkrimin objekt të punës së tyre shkencore ose mësimore<sup>5</sup>. Ky ishte shkaku i dytë i dështimit të projektit ndërakademik.

4. Dhe kështu, prej disa dhjetëvjeçarësh vijon gjendja *laissez faire*, as përmirësime, as ribotime të librit të drejtshkrimit. Për mendimin tonë, ka qenë një gabim i madh që doracaku i drejtshkrimit nuk pati asnjë ribotim, as pas ‘90-s, kur mund të ishin bërë disa ndryshime të domosdoshme. Mungesa e ribotimeve të Drejtshkrimit, në të cilat të pasqyroheshin ndryshimet terminologjike që lidheshin me përparimet në fushën e gramatikës, përditësimi i ilustrimeve, që bëhej i domosdoshëm nga përmbysja e diktaturave dhe komunikimi i lirshëm i hapësirave shqipfolëse, si dhe disa rregulla që lidhen me zbatimin e parimit simbolik, të cilat mund të pranoheshin pa asnjë kundërshtim, bëri që të ngrihej një mal me kontestime ndaj Drejtshkrimit.

Tashmë është bërë e qartë se kjo gjendje nuk mund të vijojë më. Drejtshkrimi i shqipes ka nevojë për përmirësime dhe rregullat e përmirësuara

<sup>4</sup> “Orientime të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës për çështjen e shqipes standarde”, *Gazeta shqiptare*, 11.07.2004.

<sup>5</sup> Shih: B. Bokshi. “Çështje të drejtshkrimit”, në *Propozime për drejtshkrimin*, vëll. I, ITSHKSH, Shkup, 2022, f. 37-41; K. Topalli. “Drejtshkrimi i shqipes si sistem”, në *Propozime për drejtshkrimin*, vëll. I, ITSHKSH, Shkup, 2022, f. 66-114; po ai, “Materiali që do të përgatitet për diskutim në grupin e drejtshkrimit”, në *Propozime për drejtshkrimin*, vëll. I, ITSHKSH, Shkup, 2022, f. 115-160.

të botohen, në mënyrë që libri i drejtshkrimit të jetë në tryezën e kujtdo që shkruan. Nisur nga kjo nevojë urdhëruese, por edhe nga arsyeja e dështimit të Këshillit Ndërkademiç, Kryesia e Shoqatës së Gjuhësisë Shqiptare arriti në përfundimin se duheshin mbledhur dhe botuar artikujt me propozime për përmirësimet e rregullave të botuar në shtypin shkencor, duke i menduar këto propozime si një bazë të dhënash në të cilën duhet mbështetur për të bërë përmirësimet e drejtshkrimit. Për jetësimin e projektit punoi një grup gjuhëtarësh. Për mbledhjen e artikujve ndihmuan prof. Lulëzim Lajçi, prof. as. Kujtim Kapllani dhe dr. Valbona Sinanaj. Materialet e mbledhura u skanuan, u kthyen në Word, u korrektuan e u renditën prej kumtuesit; u lexuan nga prof. Lloshi, i cili korrektoi gabime skanimit që kishin shpëtuar, si dhe shkurtoi pjesë teorike të artikujve ose hoqi ndonjë artikull thjesht teorik<sup>6</sup>; kurse prof. Emil Lajfa bëri parathënien. Pas kësaj, librat u faqosën prej kumtuesit dhe u dorëzuan për shtyp. Libri në dy vëllime “Propozime për drejtshkrimin” u botua nga Instituti i Trashëgimisë Kulturore e Shpirtërore të Shqiptarëve në Shkup dhe u është shpërndarë falas të gjithë gjuhëtarëve në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni të Veriut<sup>7</sup>.

Në dy vëllimet e “Propozimeve” janë përfshirë 110 shkrime të 57 autorëve nga Kosova, Shqipëria e Maqedonia e Veriut, të botuara në revistat shkencore të këtyre tri shteteve. Artikujt janë ndarë në 6 rubrika: Projekti ndërkademiç i drejtshkrimit (11 shkrime), shkrime që trajtojnë disa çështje (29 shkrime), drejtshkrimi i zanoreve dhe i bashkëtingëlloreve (12 shkrime), përdorimi i shkronjave të mëdha (16 shkrime), çështje gramatikore (32 shkrime) dhe fjalët e huaja (10 shkrime).

**5.** Këta libra mendojmë se përbëjnë një bazë më se të mjaftueshme për punën për përmirësimin e drejtshkrimit. Çështja është se si mund të shfrytëzohen për të bërë përmirësimet e nevojshme. Lidhur me këtë çështje e gjejmë me vend të kthehemi prapa në kohë dhe të bëjmë një paralelizëm me shtypin e fazës së fundit të Rilindjes, kur diskutohej për mënyrën se si mund të arrihej në një alfabet të vetëm. Atëherë disa prej organeve të shtypit ia linin zgjidhjen e problemit një institucioni shkencor, një këshilli të diturish; disa e shihnin zgjidhjen të një marrëveshjeje e arritur në një mbledhje të përgjithshme,

---

<sup>6</sup> Themi “u lexuan” dhe jo “u redaktuan” (megjithëse në frontespicin e të dy vëllimeve emri i Xh. Lloshit del si redaktor), pasi të gjithë artikujt e përfshirë në dy vëllimet ishin botuar në shtypin shkencor, kështu që redaktimi i tyre jo vetëm që do të ishte i pakuptim, por edhe do të përbënte shkelje ligjore.

<sup>7</sup> Një botim paralel i këtyre dy vëllimeve është bërë nga fondacioni “Alsar”, po duke e fshirë emrin e përgatitësit dhe duke vënë emrin e drejtuesit të këtij fondacioni si përgatitës i dy vëllimeve, ndërkohë që materialet iu dorëzuan të faqosura në PDF. Ndonëse qe menduar si një botim jo për qëllime fitimi, që do t’u shpërndahej të gjithë gjuhëtarëve, ai po shitet në librari me një çmim të kripur!

dmth. në një kongres; kurse disa organe të tjera mbronin pikëpamjen se kjo mund të arrihej duke pranuar mendimin e shumicës së të pyeturve, pra me anë të anketimit.

Duke i shqyrtuar këto alternativa, mundësia që përmirësimet t'i bëjë një këshill të diturish, na duket një zgjidhje jo e arsyeshme, që do të nxirrte kundërshtimet që u bënë dhjetë vjet më parë ndaj projektit ndërakademik të drejtshkrimit<sup>8</sup>. Por kësaj radhe kundërshtimet do të hidhnin në erë drejtshkrimin, sepse do të ndodhte ajo që ndodhi në Çeki në vitet '90, ku ortografinë e re nuk e pranuan shumë institucione. Edhe mundësia e mbajtjes së një Kongresi na duket një zgjidhje jo e mençur, së pari, se tashmë propozimet janë bërë dhe janë përmbledhur në një libër dyvëllimësh. Pra, një kongres nuk do të zgjidhte gjë dhe problemi do të shtyhej për në kalendat greke.

Pikërisht për këto arsye ne mendojmë se duhet ndjekur rruga e tretë, e cila është më demokratike, po njëherazi edhe më e mundshme nga pikëpamja praktike. Sot kemi një armatë prej rreth 200 gjuhëtarësh – profesorë, profesorë të asociuar dhe doktorë shkence – të cilët janë të aftë të gjykojnë për problemet e drejtshkrimit dhe të cilëve u duhet lënë në dorë zgjidhja e kësaj çështjeje që nuk pret. Një mënyrë se si duhet tërhequr mendimi i të gjithëve mund të jetë të krijohet fillimisht një komision i përbërë nga autorë të shkrimeve të botuara në “Propozime për drejtshkrimin”. Ky komision, i ndarë në grupe sipas rubrikave të këtij libri, do të nxjerrë dhe do të formulojë në formën e një pyetësoi të gjitha propozimet. Pastaj ky pyetësor do t'u përcillet elektronikisht 200 gjuhëtarëve (ndoshta edhe aktorëve të tjerë të interesuar, si botues, redaktorë etj.) dhe secili prej këtyre do të kthejë po elektronikisht përgjigjen e vet. Komisioni, pasi të marrë përgjigjet e të anketuarve, do të pranojë pa asnjë diskutim ato ndryshime për të cilat janë shprehur 90–100% e të pyeturve; propozimet me të cilat do të pajtohen 75-89% e të pyeturve të diskutohen nga komisioni, i cili do t'i përmbahet parimit të bashkëpëlqimit në vendimet që do të marrë për to. Kurse propozimet e tjera të lihen për një të ardhme jo të afërt. Sigurisht, ky proces kërkon miratimin dhe mbështetjen e Ministrive të Arsimit të të tri njësisve shtetërore, që nga fillimi e deri te botimi i Drejtshkrimit, sepse pranimin dhe zbatimin e normës e bën të detyrueshëm autoriteti shtetëror.

**6.** Kjo ka qenë ideja e Shoqatës së Gjuhësisë Shqiptare, së cilës i përmbahet autori i këtij shkrimi, duke qenë i bindur se kjo është rruga më e arsyeshme. Shpresojmë që Akademia e Studimeve Albanologjike ta vlerësojë çështjen e drejtshkrimit si çështje kombëtare të një ndjeshmërie të lartë, pasi, sikundër ka theksuar akad. Rexhep Qosja, për shqiptarët “çështja e gjuhës s'është vetëm çështje e gjuhëtarëve dhe e shkrimtarëve, por është çështje e të

<sup>8</sup> Kurse zgjidhja që përmirësimet t'i bëjë një njeri i vetëm, do të ishte një aventurë e cila do ta rrezikonte drejtshkrimin, sepse projekti i ri do të stigmatizohej si “drejtshkrimi i X-it” dhe do të kishte më shumë arsye të mos pranohej.

gjitha strukturave shoqërore”<sup>9</sup>, duke qenë se gjuha është i vetmi tipar që na bashkon si komb dhe që na dallon nga kombet e tjera. Për këtë arsye kërkohet përgjegjshmëri e lartë nga institucionet që merren me gjuhën shqipe për zgjidhjen e drejtë të problemit, për t’u dhënë shqiptarëve një drejtshkrim të pranueshëm prej tyre. Përndryshe, një drejtshkrim i kontestuar do të çartte drejtshkrimin dhe, po u çart drejtshkrimi, çartet gjuha standarde dhe pasojat e kësaj do të ishin shumë të rënda për funksionimin e shteteve shqiptare dhe për vetë njësinë tonë kombëtare. Në vlerësimin dhe zgjidhjen e këtij problemi duhet të kemi parasysh edhe përvojat jo të mira me drejtshkrimin të çekëve, gjermanëve, por dhe të projektit ndërakademik.

## SUMMARY

### PROPOSALS FOR ORTHOGRAPHY - A STARTING POINT FOR IMPROVING THE ORTHOGRAPHY OF ALBANIAN

The language norm is a linguistic response of language planners to the state of language in a certain period of time. But, as a historic category, the language norm has to reflect linguistic changes that happen in the speech acts during a large span of time. Consequently, the intervention of corpus planners of the standard language in order to reply to the new state of language is something not only normal, but also necessary. In order to keep the pace with changes, it is necessary to review periodically the orthographic norm, which reflects changes of phonetic, lexical and grammatical norms. But while these norms change in a normal way, mirroring changes in the speech of a certain period of time, the orthographic norm needs the intervention of language planners.

The question here is how and by whom the reviewing of orthographic rules has to be made: based on personal views of a small group of linguists, or based on the proposals for changes of different rules made by Albanian linguists during a 50-year period?

In this paper we are of the opinion that the second route has to be followed. The approval of changes of spelling rules has to be made by the community of language researchers, writers and editors based on the proposals. This is quite feasible, because in their hands is the book in two volumes “Proposals on orthography” (2022). To simplify their work, a questionnaire of proposals has to be made with “yes” and “no” questions. Later on, answers to this questionnaire must be filtered out in order to discern proposals that are

---

<sup>9</sup> R. Qosja. “Fjala e hapjes në simpoziumin e Prishtinës (1980)”, në *Probleme aktuale të kulturës së gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1983, f. 8.

accepted by 90-100% of the respondents, by 75-89% etc. The percentage that will be as a threshold for intervention in the rules will be decided by a group of planners, but the acceptance of changes has to be made in a conference of the above-mentioned actors.